



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

**V E N D I M**

**Nr. 35, datë 7.04.2020**

**“PËR**

**PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË VARRIMIT PËR VIKTIMAT QË HUMBIN JETËN  
NGA INFEKSIONI COVID-19, NË BASHKINË E TIRANËS”**


Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 23, pika 7, nenit 54, shkronja “f”, nenit 55, pikat 3 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenit 3/dh, pika 2, të Ligjit nr.9220, datë 15.04.2004, “Për administrimin e shërbimit të varrimit”, të ndryshuar, Vendimit nr. 243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, Vendimit nr. 711, datë 29.10.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë””, pikës 3, shkronja “g”, të Vendimit nr. 88, datë 29.12.2016, të Këshillit Bashkiak “Për likuidimin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Funerale dhe krijimin e Agjencisë së Shërbimeve Funerale”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I :**

1. Përballimin e shpenzimeve të varrimit në varrezat publike nga Bashkia Tiranë për viktimat që humbin jetën nga infeksioni Covid -19.
2. Sipas parashikimeve të këtij vendimi, shpenzimet përballohen për viktimat që kanë vendbanimin në Bashkinë Tiranë.
3. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga buxheti i miratuar për Agjencinë e Shërbimit Funeral të miratuar për vitin 2020.
4. Ngarkohen Agjencia e Shërbimeve Funerale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**KRYETARI**

  
**TONI GOGU**

